



FLET PËR "EPOKËN E RE", GJERGJ DEDAJ | FAQE 4-5

OSMANI, KURTI DHE GËRVALLA DËMTUAN DIPLOMACINË E KOSOVËS



Ish-ambasadori i Kosovës në Shkup, Gjegj Dedaj, ka thënë se diplomacia jonë kurrë nuk ka qenë më e dobët. Dedaj për dështimet në diplomaci i ka bërë përgjegjës Donika Gërvallën, Vjosa Osmanin dhe Albin Kurtin. Duke iu referuar mungesës së njohjeve të reja, ai ka thënë se diplomacia nuk mund të drejtohet me familjarë dhe militantë partiakë. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Dedaj ka thënë se Gërvalla e ka shndërruar MPJD-në në degë të Listës Guxo. Ndërsa duke iu referuar rastit të ambasadorit Martin Berishaj, ai ka theksuar se Osmani, Kurti dhe Gërvalla e kanë një zor të madh dhe nuk mund ta shkarkojnë atë

(Rebelime poetike)

HARAM MOS TË QOFTË LIRIA



Muhamet MAVRAJ

Atdheu im
Me një këmbë e gjysmë
Sot përkujton gjenocidin
luftëtarët e lirisë u shpallën non grata
nderin e fjalës e mbajnë për vete mohuesit e
djeshëm

Pra, ikën kohërat e stereotipeve morale
Ani
Por u përmbysën disa rëndë

Tani pas revolucionit
Në poezinë natyrale karvani leh
e qentë ecin

E miqtë e kafshëve
ankohen kundër njerëzve
të pavaksinuar
njeriu po e kafshon qenin

(Një kryetar i opozitës në parlament bëri
thirrje serioze: kryeministër, lidhe
zëvendësin)

Me retorikat helmuese në Presidencë,
kryeministri, parlament, gjykata speciale,
shtëpi të shkencave, kopshte, familje

Njeriu po e helmon gjarprin e shtëpisë

Mos jemi çu peshë atdheu im
Haram mos të qoftë liria

Prishtinë, 15.01.23

ÇITAKU:
QEVERIA KURTI
MOHON FJALËN
PËR UÇK-në
DHE THUR
ELOZHE PËR
IVANOVIQIN | FAQE 3



**KDI-ja PUBLIKON TË GJETURAT
E NIVELIT TË TRANSPARENCËS
PËR 38 KOMUNAT**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pendarovski: Ballkani Perëndimor, në rrezik nga ndikimet e mundshme ruse

SHKUP, 17 JANAR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, e përshkroi Ballkanin Perëndimor si një "vend i butë" në arkitekturën e sigurisë në Evropë dhe të brishtë ndaj fushatave të mundshme të ndikimit nga Rusia. Në fjalimin në Davos, në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror, Pendarovski tha se "Kremlini përbën rrezik për stabilitetin e rajonit", por tha se beson se Shtetet e Bashkuara do t'i kushtojnë më shumë vëmendje situatës në rajon. Sipas tij, përveç Ukrainës, Ballkani Perëndimor është një pikë e ndeshme në arkitekturën e sigurisë evropiane. "Ekzistojnë dy pika të ndjeshme në rajon - Republika Serpska dhe veriu në Republikën e Kosovës, ku tentohet të cenohet integriteti i këtyre vendeve, andaj NATO-ja dhe Bashkimi Evropian duhet t'i kushtojnë vëmendje", tha

Pendarovski. Ai iu referua entitetit të Republikës Serpska në Bosnjë-Hercegovinë, që ka shpeshuar thirrjet për shkëputje nga shteti dhe veriut të Kosovës të banuar me shumicë serbe. Në pjesën veriore të Kosovës në fund të vitit 2020 tensionet u rritën dhe disa serbë lokalë, për 20 ditë, përmes barrikadave bllokuan rrugët kryesore në këtë pjesë. Kosova ka fajësuar Rusinë se po e shtynë Serbinë që të nxisë tensione në Kosovë, por këto akuza janë hedhur poshtë nga Kremlini. Madje kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në barrikadat në veri ka pasur prani të elementeve ushtarake paramilitare, sikurse të grupit mercenar rus Wagner. Ky grup, po ashtu, merr pjesë në luftën që Rusia ka nisur kundër Ukrainës në fund të shkurtit të vitit të kaluar. "Nuk jam i



shqetësuar nëse do të kemi unitet dhe solidaritet transatlantik dhe panevropian edhe këtë vit, por pyes veten nëse do të ruhet kur të

përfundojë lufta në Ukrainë dhe ky është çelësi që demokracia të mbizotërojë mbi autokracinë", theksoi Pendarovski. Lideri maqedonas mori pjesë në

debatin me temën "Në mbrojtje të Evropës", ku kërkoi që të forcohet uniteti, në mënyrë që, sipas tij, të fitojë demokracia ndaj autokracisë.

Boris Pistorius emërohet ministër i Mbrojtjes në Gjermani



BERLIN, 17 JANAR - Boris Pistorius është emëruar ministër i ri i Mbrojtjes në Gjermani, ka njoftuar qeveria gjermane. Ai është anëtar i Social-Demokratëve të kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe ka shërbyer ministër i Brendshëm i landit të Saksonisë së Poshtme prej vitit 2013. Atij do t'i duhet ta finalizojë projektin për modernizim të ushtrisë së Gjermanisë dhe ta mbikëqyrë ndihmën e zgjeruar të armëve në Ukrainë teksa kjo e fundit lufton pushtimin rus. Pistoriusit do t'i duhet të

thellohet menjëherë në punën e re. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloud Austin pritet ta vizitojë Berlinin këtë javë dhe më pas ta vizitojë edhe bazën ushtarake amerikane në perëndim të Gjermanisë. Emërimi i tij vjen pas dorëheqjes së Christine Lambrecht nga kjo pozitë një ditë më parë. Ky vendim i saj vjen pasi mediet gjermane kanë raportuar të premtën se shefja e Mbrojtjes synon të japë dorëheqje pas mesazhit për Vitin e Ri që e ka postuar në rrjetet sociale.

Në të Lambrecht e ka përmendur luftën në Ukrainë, nën tingujt e fishekzjarrëve në prapavijë. Anëtarët e partisë opozitare Unioni Demokratian (CDU) kanë bërë thirrje për dorëheqjen e saj. Në deklaratën e dorëheqjes, Lambrecht ka përmendur "muaj të fokusit medial" mbi të dhe se diçka e tillë ka ndërhyrë në debatin faktik për ushtrinë dhe politikat e Gjermanisë për sigurinë. "Puna e vlefshme e ushtarëve dhe e shumë njerëzve në departamentin tim duhet të jetë në plan të parë", ka thënë ajo.

Dhjetëra të akuzuar për trazirat e 8 janarit në Brazil

RIO DE JANEIRO, 17 JANAR - Prokurori i Përgjithshëm i Brazilit ka ngritur padi kundër 39 personave nën dyshimet për përfshirje në trazirat që kanë ndodhur në ndërtesën e Senatit më 8 janar. Mijëra mbështetës të ish-presidentit Jair Bolsonaro kanë sulmuar ndërtesat qeveritare pas humbjes së tij në zgjedhje vitin e kaluar. Në padi është thënë se individët të cilët nuk janë identifikuar kanë përdorur dhunën dhe kërcënime për ta shkatërruar demokracinë. Bolsonaro ka thënë se ndien keqardhje për trazirat, mirëpo e mohon se i ka shkaktuar ato. Qindra persona janë arrestuar pas ngjarjeve të 8 janarit, pasi ndërtesa presidenciale, Kongresi dhe Gjykata Supreme janë vandalizuar, kur protestuesit

kanë tentuar të hyjnë në to. Dhjetëra zyrtarë policorë janë plagosur dhe skenat janë dënuar nga shumë liderë botërorë. Kërcënimet ndaj rendit demokratik përbëjnë çështje të ndjeshme në këtë shtet, ku regjimit ushtarak i është dhënë fund më 1985. Bolsonaro aktualisht është në Shtetet e Bashkuara, që t'i shmanget pjesëmarrjes në ceremoninë e inaugurimit të pasardhësit të tij, veteranit të krahut të majtë, Luiz Inacio Lula da Silva. Fitorja e Lulas në zgjedhjet e tetorit pati zemëruar mbështetësit e Bolsonaros. Lula, ish-president, është shpallur fajtor në akuzat për korrupsion më 2017 dhe ka qenë në burg para se të anulohet dënimi i tij.



Çitaku: Qeveria Kurti mohon fjalën për UÇK-në dhe thur elozhe për Ivanoviqin

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, në një konferencë për medie, ka akuzuar qeverinë Kurti për tri skandale të mëdha ditët e fundit. Ajo ka thënë se Albin Kurti si kryeministër po e cenon përmendjen e UÇK-së, po i thur elozhe Ivanoviqit dhe po dështon në diplomaci

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 JANAR - Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, në një konferencë për medie ka akuzuar qeverinë Kurti për tri skandale të mëdha ditët e fundit. Çitaku ka thënë Albin Kurti si kryeministër, pos që po vazhdon ta mbrojë pakusht ambasadorin Berishaj, po e cenon përmendjen e UÇK-së e po i thur elozhe Ivanoviqit si dhe

po dështon në diplomaci. “Çka ka dhe çka s’ka ditët e fundit dhe jo vetëm nga qeveria Kurti? Ka mbrojtje të pakusht për Martin Berishajn, nuk ka sjellje të tij para drejtësisë. Ka mohim të fjalës për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe elozhe për Oliver Ivanoviqin. Ka çnjohje dhe ngecje në fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, s’ka procedim të aplikacionit të Kosovës në Këshillin e Evropës. Ka një Albin Kurt në opozitë, dhe një

Albin Kurt tjetër në Qeveri”, ka theksuar ajo.

Nënkryetarja e PDK-së sërish bëri thirrje që ambasadori Berishaj të shkarkohet nga detyra dhe të hetohet afera e tij me mafinë energetike. “Tek afera Martin Berishaj, shkarkimi nuk mjafton. Të dhënat e publikuara nga mediumet e ndryshme ndërkombëtare duhet të jenë alarm për institucionet e Republikës së Kosovës.

Për më tepër, sot, më shumë se kurrë, kryeministri duhet t’u japë përgjigje një vargu të pyetjeve të cilat i kemi parashtruar tash e një vit. Si i është dhënë shtetësia Martin Berishajt brenda natës? Si e ka marrë certifikatën e sigurisë nga AKI? A janë përdorur 1 milion e 470 mijë euro për të financuar fushatën e Lëvizjes Vetëvendosje

dhe Listës Guxo”, ka deklaruar Çitaku.

Sa i përket diplomacisë, Çitaku konsideron se qeveria Kurti ka dështuar deri në atë masë sa shteti i Kosovës nuk po arrin t’i mirëmbajë dhe kultivojë raportet as me vendet që e kanë njohur më parë. “Dje ministri i Jashtëm i Togos njoftoi se kanë tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës, kur ne prisnim njohje të reja të vendit tonë. Por, kjo nuk është pjesa më e dhimbshme. Pjesa e dhimbshme është që, edhe në një organizatë si Këshilli i Evropës, ku kemi më shumë se dy të tretat e votave të nevojshme, edhe përkundër përjashtimit të Rusisë dhe Bjellorusisë, aplikimi i Kosovës vazhdon të mbetet i patrajtuar. Që nënkupton, se ne nuk po arrijmë të mirëmbajmë

dhe kultivojmë raportet as me vendet që na kanë njohur”, është shprehur ajo.

Çitaku duke akuzuar kryeministrin Kurti për nënçmim të UÇK-së, tha se historia nuk mund të fshihet dhe sikur komunikatat e Lëvizjes Vetëvendosje dhe qëndrimet e Kurtit në “Facebook”. “Në përvjetorin e masakrës së Reçakut, Qeveria ia mohoi fjalën kryetarit të Reçakut, ish-luftëtarit të UÇK-së, Adem Ramadani. Ndërkaq, të nesërmen, kryeministri Kurti thuri elozhe për Oliver Ivanoviqin. Kryeministër, nuk fshihet dhe nuk retushohet historia si komunikatat e Lëvizjes Vetëvendosje dhe qëndrimet tuaja në ‘Facebook’”, ka deklaruar nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku.



Kurti: Ne jemi të gatshëm për dialog konstruktiv

PRISHTINË, 17 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, para vizitës së tij në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, ka paralajmëruar rrezikun e “hegemonisë pansllave” të Serbisë dhe Rusisë në Ballkan.

Në një intervistë për gazetën zvicerane “Tages-Anzeiger”, Kurti ka theksuar se Serbia nuk është një vend normal, sepse nuk është distancuar nga trashëgimia e kohës së diktatorit Sllobodan Millosheviq. “Tani shtojini kësaj mosdistancimit ndaj Vladimir Putin dhe luftës së tij në Ukrainë. Demokracia ishte një interludë e shkurtër në Serbi pas përfundimit të diktaturës. Së shpejti do të bëhen 20 vjet qëkur kryeministri

properëndimor serb Zoran Gjingjiq u vra në Beograd. Që atëherë, forcat e errëta në Serbi festojnë rikthimin. Beogradi kërkon një marrëdhënie me fqinjët e tij të ngjashëm me atë që ka Moskë me Ukrainën dhe Bjellorusinë. Prandaj kjo fqinjësi është një rrezik sigurie për ne”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se Kosova është e interesuar për të arritur një normalizim të plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve bazuar në njohjen reciproke. “Ne jemi gjithmonë të gatshëm për një dialog konstruktiv”, ka deklaruar Kurti.

I pyetur se çfarë kupton me hegemoninë pansllaviste?, Kurti



është përgjigjur: “Serbia dëshiron Republikën Serbe në Bosnjë, Malin e Zi dhe veriun e Kosovës dëshiron ta kthejë në një sferë të ndikimit. Njëjtë siç silllet Rusia me Bjellorusinë dhe Ukrainën. Problemi ynë është se partnerët tanë perëndimorë besojnë se Serbia po udhëhiqet vetëm nga oportunitizmi, se është në pritje të përfundimit të epokës së Putinit dhe pastaj do të orientohet qartë drejt Evropës. Kjo është naive. Aleksandër Vuçiq më shumë pret kthimin e Donald Trump në Uashington sesa fundin e luftës në Ukrainë. 80 për qind e popullsisë ka një opinion pozitiv për Vladimir Putin. Serbia e sheh veten si pjesë e një sfere pan-sllave, ortodokse



FLET PËR "EPOKËN E RE", GJERGJ DEDAJ

Osmani, Kurti dhe Gërvalla dëmtuan diplomacinë e Kosovës

Ish-ambasadori i Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj, ka thënë se diplomacia jonë kurrë nuk ka qenë më e dobët. Dedaj për dështimet në diplomaci përgjegjës i ka bërë Donika Gërvallën, Vjosa Osmanin dhe Albin Kurtin. Duke iu referuar mungesës së njohjeve të reja, ai ka thënë se diplomacia nuk mund të drejtohet me familjarë dhe militantë partiakë. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Dedaj ka thënë se Gërvalla e ka shndërruar MPJD-në në degë të Listës Guxo. Ndërsa duke iu referuar rastit të ambasadorit Martin Berishaj, ai ka theksuar se Osmani, Kurti dhe Gërvalla e kanë një zor të madh dhe nuk mund ta shkarkojnë atë

asnjëherë më parë që nga lufta e fundit. Nuk bëhet diplomacia me familjarë, teze, halla e militantë infantilë politikë", është shprehur Dedaj.

Duke folur për rastin e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, ish-ambasadori Dedaj ka thënë se ai do të duhej të kthehej në shtëpi. Në këtë drejtim, ai ka rikujtuar kohën kur trashja Osmani, Kurti dhe Gërvalla brenda një dite kishin shkarkuar 12 ambasadorë të cilët nuk kanë qenë asnjëherë të përfolur për ndonjë aferë. "Po të ndodhte kjo aferë e përfolur ndaj meje sa isha në Shkup, çfarë kishte ndodhur. E kanë një zor Vjosa, Albini e Schwarzzi që nuk e shkarkojnë, mbase as nuk mund ta shkarkojnë nëse drejtësia i vërteton akuzat të cilat po përfolën, atëherë Berishaj nuk duhet të shkarkohet vetëm, por së bashku me Vjosën, Albinin dhe Schwarzzin", ka thënë Dedaj. Sa i përket dialogut me Serbinë, Dedaj ka thënë se ky proces është jotransparent. Ai ka thënë se Kurti do ta pranonte "Zajedincën" të cilën

e kishte kundërshtuar sa ishte në opozitë me të gjitha mjetet.

"Epoka e re": Z. Dedaj, çfarë vlerësimi keni për punën e diplomacisë së Kosovës këto gati dy vjet të qeverisë Kurti?

Dedaj: Diplomacia e Kosovës është një ndër dikasteret më të dështuar të këtij pushteti. Madje më aktive ka qenë para luftë e mos të flasim në dy dekadat pas luftës. Ardhja e zonjës Schwarz në krye të diplomacisë ishte një diskreditim dhe denigrim i politikës së jashtme të Kosovës. Për këto dy vjet nuk kemi asnjë njohje dhe asnjë sukses, pos sfilatave dhe bredhjeve nëpër botë. Të mos flasim për dëmtimin e partneritetit me miqtë tanë strategjikë euroatlantikë dhe devalvimin e imazhit të Kosovës në botë.

"Epoka e re": Këto dy vjet nuk kemi asnjë njohje të Kosovës. Sipas jush, ku qëndron problemi?

Dedaj: Njohje as nuk kishim dhe se vështirë do të kemi derisa në

krye të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës qëndron një ministere e nivelit kaq të ulët përfaqësues dhe diplomatik. Lutemi që të mos këtë çnjohje, se sa për njohje jemi shumë larg tyre. MPJD-në e ka shndërruar në një zyrë private, degë të Listës Guxo dhe ka rrënuar politikën e jashtme.

"Epoka e re": A janë përgjegjës Vjosa Osmani, Albin Kurti dhe Donika Gërvalla për pozicionin e Kosovës në arenën ndërkombëtare?

Dedaj: Padyshim se fajin kryesor e bartin Vjosa Osmani dhe Albin Kurti të cilët e kanë dëmtuar skajshëm politikën e jashtme dhe vetë të ardhmen e Kosovës si asnjëherë më parë që nga lufta e fundit. Nuk bëhet diplomacia me familjarë, teze, halla e militantë infantilë politikë. Dikur kur vizitonim qendrat ndërkombëtare të vendimmarrjes e ngrahim kokën lart, tani turpërohemi me nivelin e politikës së jashtme dhe imazhin e denigruar të Republikës

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 17 JANAR - Ish-ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, ka vlerësuar se diplomacia e Kosovës është ndër dikasteret më të dështuar të qeverisë Kurti. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Dedaj ka thënë se ardhja e Donika Gërvalla - Schwarz në krye të diplomacisë ka qenë denigrimi më i madh që i është bërë politikës

së jashtme të Kosovës.

Ai ka thënë se Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) është shndërruar në degë të Listës Guxo. Për dështimet në politikën e jashtme, Dedaj përgjegjës i ka bërë edhe presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. "Padyshim se fajin kryesor e bartin Vjosa Osmani dhe Albin Kurti, të cilët e kanë dëmtuar skajshëm politikën e jashtme dhe vetë të ardhmen e Kosovës, si

Mbahet Samiti i Investitorëve, Kurti fton bizneset private të investojnë në Kosovë

CYRIH, 17 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po qëndron në Zvicër. Në ditën e tij të parë, ai së bashku me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, shefin e stafit, Luan Dalipi, këshilltarin politik për teknologji të informacionit, Lulëzon Jagxhiu dhe këshilltaren politike të ministrit të Mjedisit,

Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Gearda Demiraj, ishin folës në Samitin e Investitorëve në Cyrih, të organizuar nga Qeveria e Kosovës.

Para më shumë se 60 ndërmarësve dhe drejtuesve të kompanive të ndryshme, në fushën e infrastrukturës,

mjedisit, energjisë, prodhimit dhe teknologjisë së informacionit, kryeministri Kurti dhe delegacioni qeveritar prezantuan mundësitë që Kosova ofron për investitorë dhe investime të huaja.

Të pranishmit u njoftuan për përparimin në fushën e sundimit të ligjit dhe për stabilitetin

institucional, për politika fiskale të zbatuara në vend, planet investive të qeverisë dhe karakteristika e fuqisë punëtore në Kosovë.

Marrë parasysh ndryshimet pozitive në dy vitet e fundit dhe kushtet e favorshme që ofrohen, kryeministri Kurti ftoi bizneset zvicerane që të investojnë në

Kosovë.

Pas prezantimeve hyrëse, kryeministri Kurti së bashku me këshilltarin e tij për Teknologji të Informacionit, Lulëzon Jagxhiu, po ashtu ishin pjesë e panelit të diskutimit në të cilin u trajtuan më detajisht specifikat dhe përparësitë e të bërit biznes në Kosovë.



Vdes akademikja Edi Shukriu

PRISHTINË, 17 JANAR - Akademikja Edi Shukriu ka vdekur të martën në moshën 73-vjeçare. Lajmin e ka dhënë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Në njoftim, Akademia e ka konsideruar Shukriun emër të njohur dhe të çmuar "në fushën e arkeologjisë, të historisë, të letërsisë, të angazhimeve

politike, institucionale dhe kulturore në Kosovë dhe në mbarë hapësirën shqiptare".

Ajo ka qenë anëtare e rregullt e Akademisë prej vitit 2020.

Përgjatë jetës së saj ajo ka qenë e angazhuar në jetën publike dhe jetësimin e barazisë gjinore.

Shukriu ka punuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme

të Kosovës dhe ka qenë deputete e Kuvendit të Kosovës në periudhat 1992-1998 dhe 2002-2004.

Ajo njihet edhe për botimet monografike dhe studimet nga fusha e arkeologjisë dhe historisë.

Varrimi i saj do të bëhet më 18 janar në varrezat e qytetit të Prizrenit.



së Kosovës në botë.

"Epoka e re": Si i keni parë raportimet në medie për dyshimet e përfshirjes së ambasadorit Berishaj në afëra milionëshe?

Dedaj: Pa dashur të spekuloj as ta prejudoj fajësinë apo pafajësinë e raportimeve për ambasadorin Martin Berishaj, sepse për këtë janë organet e drejtësisë, por raportimet e medieve të Kosovës, rajonit dhe më gjerë, po shkruajnë për një mal akuzash. Do të ishte e mjaftuar që Berishaj të kthehet derisa të vërtetohet pafajësia e tij eventuale. Vjosa, Albini dhe Donika kanë shkarkuar për një ditë 12 ambasadorë, pra në maj të vitit 2021, në kulmin e

pandemisë. Ky ishte krim brutal dhe veprim joligjor, pa qenë asnjëri nga ata i përfolur dhe pa pasur asnjë vërejtje për punën e tyre. Pas shkarkimit tim skandaloz nga pozita e ambasadorit në Shkup, unë kam folur dhe reaguar kundër këtij shkarkimi. Më 26 maj më ka ardhur vendimi nga Schwarz që më 27 maj ta liroj ambasadën (1 ditë afat) që kjo nuk ndodh as në Korenë e Veriut, as në vendet që udhëheqin nga juntat ushtarake dhe diktaturat. E Schwarz tash për Berishajn po thotë se nuk shkarkohet ambasadori për një fjalë... Kjo dëshmon se sa shumë gënjen Schwarz dhe ky pushtet, të cilët, më në fund, do të duhej të

turpëroheshin për dështimet dhe gënjeshttrat e shumta.

"Epoka e re": Sipas jush, pse nuk po shkarkohet ambasadori Berishaj?

Dedaj: Merrni me mend, po të më ndodhte kjo aferë e përfolur mua sa isha në Shkup, çfarë kishte ndodhur! E kanë një zor Vjosa, Albini e Schëarzi që nuk e shkarkojnë, mbase as nuk mund ta shkarkojnë nëse drejtësia i vërteton akuzat të cilat po përfliten, atëherë Berishaj nuk duhet të shkarkohet vetëm, por së bashku me Vjosën, Albinin dhe Schwarzin.

"Epoka e re": Z. Dedaj, bashkësia ndërkombëtare tashmë ka propozuar planin franko-

gjerman për arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi? Cili është qëndrimi juaj për këtë plan?

Dedaj: Pakkush në Kosovë e ka parë këtë planin franko-gjerman dhe nuk mund ta komentojmë korrekt dhe saktë. Është shumë jotransparent dhe misterioz i gjithë ky proces i negociatave. Duke e parë që Albin Kurti nuk e ka mbajtur asnjë fjalë dhe premtim të dhënë, ai do të pranojë edhe Zajdenicën dhe çdo gjë që i kërkohet për ta ruajtur pushtetin. Një njeri që është në gjendje ta djegë Kosovën për pushtet, ai e rrezikon Kosovën për ambicjet e tij të sëmura egocentrike dhe mentaliteti i ekstremit të majtë dhe radikal, pra është i

paparashikueshëm.

"Epoka e re": Brenda këtij plani thuhet se është edhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. A do ta pranojë kryeministri Kurti ta implementojë "Zajdenicën" të cilën sa ishte në opozitë e kishte kundërshtuar me të gjitha mjetet?

Dedaj: Kurti çdo gjë që ka kundërshtuar e ka pranuar dhe çdo gjë që ka pranuar e kundërshton. Ky njeri ka simptoma të një minidiktatori dhe ekstremisti të rrezikshëm, i cili duhet të mënjanohet sa më parë nga pushteti. Nga Rambuje e deri më sot, krejt çfarë ka thënë, e ka thënë dhe e ka bërë të kundërtën për Republikën e Kosovës.

Kosova nis fushatë për t'i mbrojtur njohjet

PRISHTINË, 17 JANAR - Diplomtatët e Kosovës kanë shtuar takimet me homologët e tyre që vijnë nga shtetet që Serbia pretendon se kanë tërhequr njohjen e Kosovës. Në fillim të janarit, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pretendoi se nëntë shtete kanë tërhequr njohjen e Kosovës dhe se janë në pritje të një shteti të dhjetë, pa specifikuar se për cilin shtet bëhet fjalë. Sipas tij, Kosovën e kanë çnjohur: Somalia, Burkina Faso, Gaboni, Esvatini, Libia, Guinea, Antigua dhe Barbuda, Shën Lucia dhe Maldivet.

Më 16 janar, ministri i Jashtëm i Togos, deklaroi në Beograd se shteti i tij ka tërhequr njohjen e Kosovës. Është e paqartë nëse Vuçiqi ka aluduar në Togon si shteti i dhjetë në pretendimin e tij për çnjohjen e Kosovës.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, tha se çnjohja e Kosovës nga Togos "ka ndodhur në vitin 2019". "Kosova do ta fitojë betejën e saj sot, ashtu siç e ka fituar më 1999. Me mençuri, trimëri, guxim, sakrificë e përplot miq e aleatë anembanë botës së lirë dhe demokratike. Dhe Serbia përsëri do të humbasë, siç ka humbur më 1999, sepse e vërteta gjithmonë fiton mbi gënjeshtren", ka shkruar ajo në "Facebook".

Përveç Togos, MPJD ka hedhur poshtë këto pretendime të Serbisë përmes një reagimi zyrtar. Zyrtarët kosovarë, po ashtu, kanë bërë publike takimet e tyre me përfaqësuesit e disa prej shteteve që gjenden në listën e prezantuar nga Vuçiqi, si pjesë e përpjekjeve për t'i hedhur poshtë pretendimet e liderit serb.

Me cilat shtete u takuan ambasadorët e Kosovës?

Gjashtë ditë pas deklaratës së Vuçiqit, më 10 janar, ambasadori i Kosovës në Turqi, Agon Vrenezi, u takua me homologun e tij somalez Jama Abdullahi Mohamed. Sipas njoftimit të Ambasadës së Kosovës në Ankara, dy diplomatët diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit mes shteteve. Por këtë takim pala somaleze ka zgjedhur që të mos e paraqesë në llogaritë në rrjetet sociale e as në uebfaqen e Ambasadës së saj në Turqi.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, thuhet se Somalia e ka njohur Kosovën më 19 maj 2010.

Më 11 janar ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami, njoftoi për takimin me ambasadorin e Libisë në Belgjikë, Amel Jerary. Bajrami ka shkruar në "Twitter" se me Jeraryn kanë pasur një "diskutim të mirë dhe mirëkuptues" dhe se kanë këmbyer pikëpamje për situatën në dy shtetet respektive dhe për rëndësinë e "stabilitetit,



demokracisë për paqe si në Ballkanin Perëndimor dhe në Libi". "U pajtuam që t'i thellojmë raportet Kosovë - Libi", ka shkruar Bajrami. Megjithatë, takimin me Bajramin, Jerary nuk ka zgjedhur ta bëjë publike në llogarinë e saj në "Twitter". Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Libia e ka njohur pavarësinë e Kosovës më 25 shtator të vitit 2013. Po të njëjtën ditë ambasadori i Kosovës në Kanada, Adriatik Kryeziu, publikoi në "Twitter" lajmin se ka takuar të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Gabonit në Kanada, Engone Rosine Epouse Oliveira.

Pavarësisht se Vuçiqi pretendoi se Gaboni ka tërhequr njohjen e Kosovës, Kryeziu tha se me homologen e tij diskutoi për "raportet aktuale dypalëshe dhe për bashkëpunimin në të ardhmen".

Gaboni, shtet në Afrikën Qendrore, njohu pavarësinë e Kosovës më 15 shtator 2011. Ambasada e këtij shteti në Kanada nuk ka pasqyruar takimin e të ngarkuarës së tyre me punë në këtë institucion me ambasadorin Kryeziu.

Ndërkaq, me përfaqësuesen e përhershme në Kombeve të Bashkuara, të Maldives, u takua kreu i Konsullatës së Përgjithshme të Kosovës në Shtetet e Bashkuara, Blerim Reka. Reka shkroi në "Twitter" më 12 janar se me ambasadorin e Maldives, Thimeeza Hussain, ka rikonfirmuar "raportet e shkëlqyera dypalëshe".

Për dallim nga Hussain, që nuk postoi asgjë për këtë takim me Rekën, e as misioni i Maldives në OKB, Ambasada e këtij shteti në Japoni bëri të kundërtën.

Më 13 janar u njoftua se Ambasada e Maldives në Japoni e kishte vizituar ambasadori i Kosovës në Japoni, Sabri Kiçmari. "Biseduam për mënyrat se si t'i forcojmë lidhjet dypalëshe dhe

shumëpalëshe dhe t'i forcojmë fushat e bashkëpunimit midis Maldives dhe Kosovës", u tha në postim, që u shoqërua me një foto të takimit.

Maldivet, shtet në Oqeanin Indian, njohu pavarësinë e Kosovës një vit e dy ditë pas shpalljes, përkatësisht më 19 shkurt 2009.

Diplomatët e Kosovës janë takuar edhe me përfaqësuesit e një shteti tjetër, që Serbia pretendon se ka tërhequr njohjen e Kosovës. Bëhet fjalë për Esvatinin, i njohur më herët me emrin Svaziland - shtet që gjendet në kontinentin afrikan.

Ambasadori i Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, Ilir Kapiti, e vizitoi ambasadën e tij këtij shteti në Londër më 12 janar. "Ishte kënaqësi të diskutonim për ngjarjet botërore dhe ne mirëpresim forcimin e raporteve midis Kosovës dhe Esvatinit, duke eksploruar mundësitë ekonomike", ka shkruar Kapiti pas takimit me komisionarin e lartë të këtij shteti në Londër, Thandazile P. Mbuyisa.

Përveç këtyre takimeve të bëra publike, MPJD më 5 janar deklaroi se pretendimet e Vuçiqit për tërheqjen e njohjeve nuk qëndrojnë dhe nuk janë vërtetuar as nga takimet me përfaqësuesit e shteteve në fjalë, "por as pas konsultimit me partnerët e rëndësishëm të vendit tonë". "Serbia duhet që urgjentisht të heqë dorë nga sulmet agresive ndaj Kosovës dhe sovranitetit të saj dhe t'i kthehet tryezës së negociatave me qendër njohjen e ndërsjellë", u tha në reagimin e MPJD-së.

Fushata e Serbisë për çnjohje

Që kur Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008, Serbia e ka kundërshtuar atë dhe ka tentuar t'i bindë shtetet që të mos e njohin Kosovën ose ta tërheqin njohjen. Pavarësisht se Serbia shpesh ka njoftuar për tërheqjen e njohjes,

ekspertët kanë thënë se, sipas normave ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare, nuk mund të tërhiqen njohjet.

Serbia ka nisur fushatën për çnjohje që nga viti 2017, ndërkaq që nga pavarësia tenton ta bllokojë Kosovën që të anëtarësohet në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë.

Më herët Serbia kishte pretenduar se Kosovën e kishin çnjohur këto shtete: Sao Tome dhe Principe, Surinami, Guinea Bisao, Burundi, Liberia, Papua Guineja e Re, Lesoto, Komonuelthi i Dominikës, Grenada, Unioni i Komoreve, Ishujt Solomon, Madagaskari, Palau, Togo, Republika Qendrore e Afrikës, Gana, Siera Leone dhe Nauru.

MPJ e Serbisë ka pretenduar se Surinami ka qenë vendi i parë që ka tërhequr njohjen e Kosovës në fund të tetorit të vitit 2017. Burundi, sipas Beogradit, ka njoftuar institucionet e Serbisë në shkurt të vitit 2018, pasuar nga Lesoto, Republika Domenikane dhe Grenada në tetor të po atij viti. Ndërkaq, në janar të vitit 2019, Serbia pretendoi se edhe Palau ka tërhequr njohjen e Kosovës.

Qeveria e Serbisë, po ashtu, më herët kishte njoftuar se ka hequr vizat për qytetarët e këtyre shteteve pas tërheqjes së njohjes së Kosovës. "Radio Evropa e Lirë" kishte raportuar më 2019 se, përveç Serbisë, edhe aleatja e saj, Rusia, kishte hequr vizat për qytetarët e këtyre shteteve.

Serbia është varur shumë në ndihmën e Rusisë kur bëhet fjalë për pengimin e Kosovës në anëtarësimin në organizata dhe mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë.

Rusia, një prej pesë anëtareve të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara së bashku me Kinën, nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe mbështesin Serbinë.

Marrëveshja e Uashingtonit

Më 2020 në Shtëpinë e Bardhë Kosova dhe Serbia kishin arritur një marrëveshje për normalizim ekonomik, por që përfshinte shumë fusha, përfshirë atë të diplomacisë.

Sipas marrëveshjes, Serbia u pajtua për një moratorium njëvjeçar në ndaljen e fushatës për çnjohjet e pavarësisë së Kosovës, ndërkaq Kosova u pajtua që brenda kësaj periudhe të mos aplikonte për anëtarësim në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë.

Pavarësisht se ka skaduar ky moratorium, ShBA-ja u ka bërë thirrje palëve që të vazhdojnë ta respektojnë të njëjtin.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Kosova përfitoi edhe një njohje, atë nga Izraeli.

Që nga 1 shkurti i vitit 2021, kur Kosova dhe Izraeli vendosën marrëdhëniet diplomatike, Kosova nuk është njohur nga asnjë shtet tjetër. Dhe pavarësisht prej pretendimeve të Serbisë, autoritetet në Kosovë nuk kanë ndryshuar numrin e njohjeve, duke thënë se janë 117 shtete që e njohin pavarësinë e saj.

Teksa Serbia vazhdon të pretendojë se shtete të ndryshme po tërheqin njohjet për të, Prishtina dhe Beogradi, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, zhvillojnë dialog, me qëllim të normalizimit të plotë të raporteve.

Kosova kërkon që dialogu që mbështetet edhe nga Shtetet e Bashkuara të përfundojë me një marrëveshje që do të kishte në qendër njohjen e ndërsjellë. Ndërkaq Serbia e ka cilësuar si "vijë të kuqe" njohjen e Kosovës dhe kërkon që dialogu të përfundojë me një zgjidhje kompromisi, pa elaboruar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

KDI-ja publikon të gjeturat e nivelit të transparencës për 38 komunat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 JANAR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në partneritet me konsorciumin e organizatave joqeveritare "Aleanca Qytetare për Transparencë" ka publikuar Transparencetrin Komunal, ku pasqyrohen të gjeturat e nivelit të transparencës së institucioneve lokale për 38 komunat e Kosovës për gjysmën e dytë të vitit 2022 (korrik - dhjetor).

Komunat janë vlerësuar në gjithsejtë 48 indikatorë specifikë që masin elemente të rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe përmbushjen e obligimeve ligjore që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien e tyre në raport me qytetarët e tyre.

Bazuar në të gjeturat gjatë kësaj periudhe, 10 komunat të cilat prijnë me nivelin e transparencës në Kosovë janë: komuna e Rahovecit me 90 pikë (93.75 për qind), komuna e Lipjanit me 89 pikë (92.71 për qind), komuna e Prizrenit me 88 pikë (91.67 për qind), komuna e Drenasit, Gjakovës, Kamenicës, Pejës dhe Prishtinës me nga 87 pikë (90.63



për qind), komuna e Mitrovicës së Jugut me 86 pikë (89.58 për qind) dhe ajo e Podujevës me 84 pikë (87.5 për qind).

Ndërkaq, komunat që qëndrojnë më se keqi në raport me transparencën janë ajo e Zveçanit me 43 pikë (44.79 për qind), e Novobërdës me 37 pikë (38.54 për qind), e Parteshit me 35 pikë (36.46 për qind) dhe e Zubin Potokut me 33 pikë (34.38 për qind).

Është për t'u vlerësuar fakti se gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022, 82 për qind e të gjitha komunave të Kosovës (31 komuna) kanë shënuar përparim në transparencë krahasuar me periudhën e parë të vitit 2022.

Vetëm katër komuna kanë shënuar regres dhe tri të tjera kanë pasur performancë të njëjtë sikur në gjysmën e parë të vitit 2022.

Rritjen më substanciale e kanë shënuar: komuna e Shtimes me 25 pikë, pra nga 55 pikë sa kishte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, në 80 pikë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022. Pas saj përmirësim të ndjeshëm kanë shënuar edhe komuna e Obiliqit me një rritje prej 23-pikësh, komuna e Klinës dhe Vushtrrisë me një rritje prej 17 pikëve, si dhe komuna e Deçanit me një rritje prej 16 pikëve krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2022.

Vlerësimi i transparencës së komunave Korrik - Dhjetor 2022

Komuna	Pikët	Përqindje
1 Rahovec	90	93.75
2 Lipjan	89	92.71
3 Prizren	88	91.67
4 Drenas	87	90.63
5 Gjakovë	87	90.63
6 Kamenicë	87	90.63
7 Pejë	87	90.63
8 Prishtinë	87	90.63
9 Mitrovicë e Jugut	86	87.5
10 Podujevë	84	89.58
11 Hani i Elezit	80	83.33
12 Skenderaj	79	82.29
13 Malishevë	78	81.25
14 Suharekë	82	85.42
15 Ferizaj	82	85.42
16 Kaçanik	80	83.33
17 Klinë	80	83.33
18 Shtime	80	83.33
19 Vushtrri	80	83.33
20 Istog	79	82.29
21 Gjiçan	78	81.25
22 Viti	74	77.08
23 Junik	73	76.04
24 Obiliq	71	73.96
25 Deçan	70	72.92
26 Dragash	68	70.83
27 Graçanicë	75	72.92
28 Mamushë	63	65.63
29 Shtërpcë	56	58.33
30 Fushë Kosovë	50	52.08
31 Mitrovicë e Veriut	49	51.04
32 Leposaviq	48	50
33 Kllokot	45	46.88
34 Ranillug	44	45.83
35 Zveçan	43	44.79
36 Novo Bërdë	37	38.54
37 Partesh	35	36.46
38 Zubin Potok	33	34.38

“Ministrja Haxhiu vazhdon me deklaratatë të pavërteta për sistemin prokurorial të Kosovës”

PRISHTINË, 17 JANAR - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kundërshtuar deklaratën e ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, lidhur me, siç thotë ajo, “mosvullnetin e as interesin për trajtimin serioz të krimeve të luftës nga sistemi prokurorial i Kosovës në krye me ish-kryeprokurorin Lumezi”. Sipas KPK-së, deklarata e ministres Haxhiu nuk është e vërtetë, sepse Këshilli Prokurorial i Kosovës ka caktuar katër prokurorë në Departamentin për Krime të Luftës të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. “Për ta mbështetur këtë departament, po ashtu, janë caktuar edhe gjashtë bashkëpunëtorë



profesionalë dhe dy zyrtarë ligjorë. E pavërteta e thënë nga ministrja Haxhiu është e dëshmuar lehtë, me marrjen e

mandatit të ish-kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, janë marrë veprime konkrete si: janë lëshuar 72 urdhërarreste

ndërkombëtare për arrestimin e të dyshuarve për krime luftarë, janë ndërmarrë veprime konkrete hetimore në drejtim të zbulimit të kryesve të veprave penale dhe kundër urdhërdhënësve, janë ngritur dhjetëra aktakuza, është përgatitur baza e të dhënave në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për rastet e krimeve të luftës dhe është harmonizuar kjo databazë me atë të Policisë së Kosovës. Me iniciativën e ish-kryeprokurorit Lumezi është përgatitur dhe miratuar Strategjia për Trajtimin e Rasteve të Krimeve të Luftës. Këto dhe shumë veprime të tjera janë duke u ndërmarrë në baza

ditore për hetimet e krimeve të luftës në Kosovë”, thuhet në reagimin e KPK-së. Këshilli Prokurorial i Kosovës vlerëson lart angazhimin dhe gatishmërinë profesionale të ish-kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, për forcimin e Prokurorit të Shtetit si një institucion i qëndrueshëm dhe i gatshëm për t'u ballafaquar me rastet me të rënda në Republikën e Kosovës të cilat deri në vitin 2015 ishin në kompetencë të EULEX-it. “Prandaj, çfarëdo tendence për të mos njohur të arriturat institucionale nënkupton marginalizim të të arriturave shtetërore”, theksohet në reagimin KPK-së.

Sali Bislimi: Kryeministri Kurti noton në ujëra të turbullta

PRISHTINË, 17 JANAR - Veprimtari dhe drejtori i OJQ “Zëri Perëndimor i Kosovës”, Sali Bislimi, ka komentuar videon e kryeministrit Albin Kurti i cili ka përkujtuar të hënën politikanin serb Oliver Ivanoviq, i vrarë pesë vjet më parë.

Ai në “Facebook” ka shkruar se është revoltues që kryeministri Kurti me pietet nderon “figurën kriminale serbe Oliver Ivanoviqin, dorën e djathtë të

Millisheviqit”. Sipas tij, kryeministri Kurti është duke notuar në ujëra të turbullta. “Krimineli Oliver, pjesëmarrës në vrasjen e shqiptarëve në vitin ‘99, i dënuar për 9 vite heqje lirie nga trupi gjykues i EULEX-it. Kryeministri Kurti me këtë akt të turpshëm anti-njerëzor dhe anti-kombëtar amnistion krimet serbe në Kosovë duke filluar me kryekriminelin siç ishte Ivanoviq. Kjo paraqitje skandaloze vret për se dyti

shqiptarët e viktimizuar nga dora e tij. Kosova me këtë kategori politikanesh rrezikon ardhmërinë, ose duhet të japë dorëheqje për çështje shëndetësore”, ka shkruar Bislimi, duke theksuar se a ka njeri të mençur që e këshillon kryeministrin. “Nuk i ke njohur ëndrrat e Oliverit kryeministër. Nuk e ke njohur dorën e djathtë të Millosheviqit. Ju doni që ëndrra e tij të jetojnë për



shfarosjen e shqiptarëve nga trojet e veta. A ke ndonjë njeri të mençur aty që të këshillon dhe të kufizon, apo

rrethohesh me pro jugosllavë. Mos je kanë i dehur, dhe s'po di çka flet. E pabesueshme. Turp!”, ka shkruar Bislimi.

Mavraj: Lamtumirë Ceno! Do të vijjnë ditët për nderimin meritor!

Prishtinë, 17 janar - Të hënën në Glogjan të Deçanit i është dhënë lamtumira e fundit ish-luftëtarit të orëve të para të UÇK-së, Cen Aliçkaj, i cili ndërroi jetë më 14 janar.

Cenë Aliçkaj ishte një veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare, ushtar i devotshëm i lirisë dhe epror i lartë i FSK-së. Por në varrimin e tij dhe në akademinë komemorative askush prej tre krerëve të shtetit nuk mori pjesë.

Publicisti Muhamet Mavraj përmes një shkrimi në "Facebook" ka shkruar se Cen Aliçkaj nuk është i rëndësishëm veç pse mori pjesë në tri luftërat e fundit në Kosovë, Kosovë Lindore e Maqedoni, por se do të luftonte edhe në tri tjera. "Të tillë i ka edhe shokët", shkruan Mavraj.

Ai thotë se shteti i tyre ua nderon armiqtë me ndjenja familjariteti e jo këto legjenda!

"Do të vijjnë ditët për nderimin meritor! Lamtumirë Ceno!", ka shkruar publicisti Mavraj.

Postimi i Mavrajt:

Janarët. Kurrë nuk kalojnë pa marrë tager të rëndë nder ne.

Legjenda Cen Aliçkaj bëri ditën e parë në varrezat e dëshmorëve në Glogjan.

Ky nuk është i rëndësishëm veç pse mori pjesë në tri luftërat e fundit në Kosovë, Kosovë Lindore e Maqedoni, por se do të luftonte edhe në tri tjera. Të tillë i ka edhe shokët.

Dhe, shteti i tyre ua nderon armiqtë me ndjenja familjariteti e jo këto legjenda!

Do të vijjnë ditët për nderimin meritor! Lamtumirë Ceno!



Cen M Aliçkaj
(29.04.1964 - 14.01.2023)



LËVIZJA NË GJILAN, VITI DHE KAMENICË, ISHTE VAZHDUESJA E DREJTËPËRDREJTË E IDEALEVE TË HERONJËVE TË KOMBIT KADRI ZEKA, REXHEP MALAJ, NUHI BERISHA, ZIJA SHEMSIU E TË TJERË



Ismet SYLEJMANI

*Të dashura familje të dëshmorëve,
Invalid të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të dashur shokë veteran të lëvizjes për çlirim të Atdheut,
Ish të burgosur politik
I nderuar Kryetar i Kuvendit të Gjilanit,
Enderuara Nënkrjetare e Komunës,
I dashur ish - Komandant i Zonës Operative të Karadakut Ahmet Isufi,
I nderuar Zëvendëskomandant e Zëvendësmministër i Mbrojtjes Shemsi Syla,
I dashur Kryetar i Rahovecit shoku Smajl Latifi,
Të nderuar të pranishëm!*

Sikur kudo nëpër pjesë të ndryshme në Kosovë e vise në ish- jugosllavi, edhe në Gjilan, në Viti dhe në Kamenicë, Lëvizja Popullore e Kosovës- LPK, ishte vazhduese dhe bartëse e drejtëpërdrejtë e aktivitetit ilegal politik-patriotik, ushtarak-çlirimtar, dhe realizuese e aspiratave lirishtetëse me kontinuitet e disiplinë të lartë atdhetare e kombëtare!
Për dallim nga rrethet tjera organizative dhe krahinat e famshme lirishtetëse të luftës kundër eskadronëve që mbillnin vdekje e zgjeronin tokën me varre në Atdheun tonë, Anamorava jonë e dashur, ishte ajo krahinë e Atdheut tonë, e cila për m2(metër katror), kishte më shumë se çdo pjesë tjetër, figura e personalitete të mëdha kombëtare të cilët e dominonin skenën politiko-patriotike ilegale në Kosovë e vise dhe kishin ndikim edhe në Shqipëri dhe jashtë Atdheut e kudo nëpër kontinente të botës!
Udhëheqësit e mëdhenj, disa nga të cilët më vonë u shëndërruan në Heronjë të lavdishëm të Kombit, ishin baza jonë e madhe dhe solide, për të qenë me çdo kusht të suksesshëm në rrugën e luftës ilegale atdhetare për liri e pavarësi nga Serbia pushtuese!
Pas arrestimit dhe dënimit me vite të tëra burg të çelikut të qendresës, Heroit të Kombit Rexhep Malaj, pas daljes jashtë Atdheut të Anëtarit të Komitetit Drejtues të GMLK-së,

atdhetarit të madh, Heroit të Kombit Kadri Zeka dhe pas kalimit në ilegalitet të Sekretarit Organizativ Hydajet Hysenit, pas arrestimeve, burgosjeve dhe më vonë edhe denimeve me vite të tëra burg të antarëve të Grupit Revolucionar dhe Grupi Marksist-Leninist i Kosovës - GMLK-së, goditja ishte e madhe në nivel të Kosovës në përgjithësi dhe të Gjilanit, të Vitisë e të Kamenicës në veçanti, por me pasojë edhe në Luginë të Preshevës e në Karadakun e Kumanovës!

NGJARJET E SHËNUARA TË VEPRIMTARISË SË LËVIZJES NË GJILAN

Më 27 mars 1989 në Gjilan, ishte demonstrata e parë e zhvilluar pas atyre që kishin organizuar gjenerata e artë e Rexhep Malës, Kadri Zekës, Nuhi Berishës, Zija Shemsiut, Hydajet Hysenit, Nazmi Hoxhës, Bejtullah Tahirit, Fazli Abdullahut e shumë bijëve të tjerë të mëdhenj e të organizuar të popullit tonë. Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, në Gjilan ka organizuar, ka drejtuar dhe ka marrë përgjegjësinë për demonstratën e 27 Marsit të vitit 1989, në të cilën ra Dëshmori i Kombit Agim Rashiti!
Natën e 19 Janarit 1990, Gjilani, Viti dhe Kamenica ishin të mbushura me traktin e Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK, i cili ishte hartuar me rastin e mbajtjes së Kongresit të 14-të të jashtëzakonshëm të LKJ-se, dhe u shpërmda në rrethin tonë, me rastin e vizitës së tradhetarit Rrahman



Morina në Hodonoc të Kamenicës!
Me 29 Janar 1990, ne demonstratën e organizuar dhe drejtuar nga Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, ra Dëshmori i Kombit Reshat Ymeri!
Këshilli i Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës -LPK, më 11 Janar 1991 e ka shpërndarë ftesën e Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK, për Homazh në përvjetorin e 7-të rëniës së Heronjëve të Kombit Rexhep Malaj e Nuhi Berisha!
Këshilli i Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK në Gjilan ka organizuar shpërndarjen e traktit, për mos përgjigje të regrutëve shqiptar për shërbim ushtarak në ish-jugosllavi, shkrimin e parullave të ndryshme me përmbajtje atdhetare e patriotike, me emra heronjesh e dëshmorësh dhe udhëheqësish të Kombit!

Këshilli ynë i Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK e ka pasur përfaqësuesin e vet Anëtar në Komitetin Drejtues të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK!
Anëtar i Këshillit tonë të Rrethit të Anamoravës nga Gjilani, Anëtar në Komitetin Drejtues të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK, e ka mbajtur fjalimin qëndror në emër të Lëvizjes Popullore të Kosovës, më 2 Qershor 1991, para masës 100.000 pjesëmarrësve në varrimin e Martirit të Kombit Fehmi Ademi, i vrarë nga forcat serbe në Korroticë të Drenicës!
Këshilli ynë i Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK të Anamoravës, e ka pasur përfaqësuesin e vet në delegacionin zyrtar të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK në dy udhëtime në Shqipëri në përbërje: herën e parë në Qershor 1991, Arif Seferi dhe Ismet Sylejmani, dhe herën e dytë në shtator 1991, në përbërje: Xhavit Haziri, Ahmet Haxhiu, Arif Seferi, Xhavit Haliti dhe Ismet Sylejmani!

Anëtar të këtij delegacioni të Lëvizjes kanë zhvilluar takimin e njohur dhe historik me Presidentin Ramiz Alia, ku është marrë vendimi për fillimin e ushtrimeve dhe përgaditjeve ushtarake!
Kryetari Këshillit të Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK të Anamoravës, Heroi i Kombit Xhevat Qerimi, ishte njëri nga udhëheqësit e mëdhenj të Lëvizjes në ushtrimet dhe përgaditjet ushtarake në

Shqipëri!

Delegati i Këshillit të Rrethit të Lëvizjes nga Anamorava, në Mbledhjen e Tretë në Ujmir e cila zhvilloi punimet më 3 dhe 4 Tetor 1991, ishte atdhetari e patrioti, ish i burgosuri politik Nazmi Hoxha, i cili nga delegatët e Mbledhjes u zgjodh në Kryesi të punës dhe më vonë edhe Anëtar i Kryesisë së udhëheqës të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK!
Duhet të jemi të lumtur e të nderuar që Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, më 17 Nëntor 1994, kurorëzoi me sukses aspiratat dhe ëndrrat e qindra dhe mijëra heronjëve, dëshmorëve, atdhetarëve e ish të burgosurve politik, baballarëve e nënave, motrave e vëllezërve, kur themeloi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës!

stërgjyshore në Luginë të Preshevës!
Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, themeloi me 2001 Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoninë e Veriut, e cila bëri luftë heroike e çlirimtare, që përfundoi me Marrveshjen e Ohrit dhe e bëri edhe de jure zot të fateve të veta popullin shqiptar në IRJ të Maqedonisë!
Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, thirri të gjitha partitë politike dhe organizoi në Gjilan, tubimin më të madh e gjithëpopullor më 31 Mars 2000, në nderim të 19 vjetorit të ngjarjeve të mëdha e të lavdishme të vitit 1981!

Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, thirri të gjitha partitë politike dhe organizoi në Gjilan, tubimin e madh gjithëpopullor me 31 Maj 2001, në



Sot në mesin tonë është Abdylmexhit Karaga nga Kërçova e Maqedonisë, i cili ishte shqiptari i parë dhe i vetëm, që Komunikatën numër 11 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e ka bartur nga Zvicra në Shkup dhe nga Shkupi e ka drejtuar në të gjitha qendrat e botës!
Përshendetje!

Pas përfundimit të luftës së UÇK-së, e cila i ndihmua nga NATO dhe aleati ynë i madh Shtetet e Bashkuara të Amerikës-SHBA, dhe çlirimit më 12 Qershor 1999 të Kosovës nga Serbia pushtuese, Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK nuk e ndali aktivitetin e saj!
Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, në vitin 2000 themeloi Ushtrinë Çlirimtare për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc - UÇPMB-në, e cila derdhi gjak, bëri luftë të madhe dhe ngriti në një stad tjetër gjendjen e popullit shqiptar në trojet e veta

nderim të ardhjes në Kosovë të Fuqisë Planetare - Shteteve të Bashkuara të Amerikës!
Anëtarët e Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK, që ranë në krye të detyrës e që derdhën gjak për Atdheun dhe u shpallën Dëshmor të Kombit, janë: Agim Rashiti, Reshat Ymeri, Xhevat Qerimi, Tefik Zymberi dhe Hanumshahe Abdullahu!
Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, dhe të gjitha pararendëset e saj, janë thesari i madh i të kaluarës së popullit tonë, e cila në memorijen e historisë së Atdheut dhe Kombit tonë, do të shkruhet me shkronja të arta e do të kenë vend nderi në ballë të flamurit kombëtar!

Lavdi Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit!
Lavdi Lëvizjes Popullore të Kosovës!

Firmat në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore po investojnë pavarësisht prej përkeqësimit të kushteve



“Epoka e re”

PRISHTINË, 17 JANAR - Sipas rezultateve të Anketës së Investimeve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQLJ), të kryer nga Banka Evropiane e Investimeve, në tremujorin e dytë të vitit 2022 kompanitë në këto vende deklaruan se kushtet e financimit ishin përkeqësuar në mënyrë drastike, edhe më shumë se mesatarja e BE-së. Ato prisnin që kushtet e biznesit në sektorët e tyre të vazhdonin të përkeqësoheshin së bashku me klimën e përgjithshme ekonomike dhe politike. E, megjithatë, në bilanc firmat në EQLJ kanë planifikuar të investojnë më shumë gjatë vitit 2022 sesa bënë në vitin 2021. Një burim nxitës për këtë ka qenë pandemia, e cila i shtyu firmat të bëhen më digjitale, të zhvillojnë produkte të reja dhe t'i shkurtojnë zinxhirët e tyre të furnizimit. Përdorimi i teknologjive të avancuara digjitale është përhapur (interneti i sendeve, kompanitë e mëdha të të dhënave,

inteligjenca artificiale, printimi 3-D etj.): 67 për qind e kompanive të EQLJ-së raportojnë se përdorin të paktën një teknologji të avancuar digjitale, duke ngushtuar hendekun me ShBA-në (71 për qind) në përputhje me tendencën e përgjithshme të BE-së (69 për qind).

Në përgjigje të presionit për t'u përshtatur dhe për novatorizëm, një pjesë më e madhe e firmave në EQLJ synojnë t'i japin përparësi novatorizmit gjatë tre vjetëve të ardhshme sesa në Bashkimin Evropian në tërësi (27 për qind kundrejt 24 për qind) apo në ShBA (21 për qind).

Zëvendës-presidentja e BEI-t, Lilyana Pavlova, ka thënë se kjo anketë ekonomike vë në dukje se ndikimi i krizës aktuale të energjisë është edhe më i theksuar në EQLJ sesa në pjesët e tjera të Bashkimit Evropian. “Një përgjigje e rinovueshme dhe e qëndrueshme është mënyra më e mirë për ta mbështetur sigurinë energjetike të Evropës. Për ta përshpejtuar tranzicionin e gjelbër dhe për ta reduktuar

varësinë e rajonit nga lëndët djegëse fosile, BEI planifikon ta nxisë financimin e energjisë së pastër dhe të mobilizojë deri në 115 miliardë euro investime për efikasitetin, burimet e rinovueshme, rrjetet, infrastrukturën e karikimit dhe ruajtjen e energjisë”, ka thënë Pavlova.

Debora Revoltella, shefe e Departamentit të Ekonomisë e BEI-t, ka theksuar se goditjet e përsëritura në tre vjetët e fundit kanë sjellë sfida të shumta për kompanitë në të gjithë EQLJ-në dhe pjesën tjetër të Evropës. “Firmat në EQLJ po ndërmarrin masa: Ato po i japin përparësi novatorizimit (më shumë se mesatarja e BE-së), duke mbetur të orientuara drejt eksportit dhe duke përqafuar teknologjitë e avancuara digjitale (në përputhje me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Megjithatë, më pak firma në EQLJ investojnë në asete jomateriale (kërkim-zhvillim, programe kompjuterike dhe trajnim) sesa në Bashkimin Evropian në tërësi. Pasiguria dhe aftësitë, së bashku me

kostot e energjisë, janë barrierat më të rëndësishme afatgjata për investimet”, ka deklaruar Revoltella.

Më shumë investime në novatorizmin dhe trajtimin e ndryshimeve klimatike

Rreth gjysma e bizneseve raportuan se ndryshimet klimatike ndikojnë në aktivitetet e tyre, me një në dhjetë që raporton “ndikim të madh”. Megjithatë, vetëm një e treta e tyre kishte përmirësuar qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve fizike që lidhen me ndryshimet klimatike gjatë vitit të kaluar financiar. Firmat në Rumani (49 për qind) dhe Estoni (40 për qind) kishin më shumë gjasa ta kishin përmirësuar rimëkëmbjen e tyre, ndërsa ato në Hungari kishin më pak gjasa (21 për qind). Shumica e firmave po ndërmarrin veprime për t'i reduktuar emetimet e tyre të gazeve të efektit serrë, veçanërisht në Rumani (93 për qind) dhe Poloni (90 për qind), por më pak në Bullgari (70 për

qind). Ndryshe nga Bashkimi Evropian në përgjithësi, firmat në EQLJ janë më të prira ta perceptojnë kalimin në standarde më të rrepta klimatike si një rrezik dhe jo si një mundësi. Sektori i infrastrukturës në veçanti e sheh si rrezik kalimin në një ekonomi me emetime neto zero gjatë pesë vjetëve të ardhshme (41 për qind). Në nivel kompanie e njëjta gjë vlen për firmat lituaneze (43 për qind); kompanitë në Rumani, nga ana tjetër kanë më shumë gjasa ta shohin ekonominë e gjelbër si një mundësi.

Në të njëjtën kohë, Lituania ka pjesën më të lartë të firmave që kanë investuar tashmë dhe që planifikojnë të investojnë në përballjen me ndryshimet klimatike gjatë tre vjetëve të ardhshme, e ndjekur nga Rumania dhe Sllovenia.

Tregtia ndërkombëtare

Firmat e EQLJ-së mbetën jashtëzakonisht të orientuara drejt eksportit dhe të hapura ndaj tregtisë ndërkombëtare, por u përballën me pengesa të ndryshme tregtare. Shumica e firmave në sektorin e prodhimit (94 për qind) dhe e firmave të mëdha (79 për qind) raportuan se ishin të angazhuara në tregtinë ndërkombëtare, veçanërisht Sllovenia dhe Sllovakia. Katër nga pesë firmat në EQLJ patën pengesa në tregtinë e tyre ndërkombëtare që nga viti 2021 dhe pothuajse gjysma deklaruan se lufta Rusi - Ukrainë dhe Covid-19 penguan biznesin e tyre.

Ndërrhyrja e këtyre firmave me masa për t'i zbutur pengesat ishte më e lartë se mesatarja e BE-së (45 për qind kundrejt 37 për qind për të gjithë BE-në). Në veçanti, për t'i diversifikuar rreziqet, 63 për qind e kompanive të EQLJ-së raportuan se kishin rritur numrin e partnerëve tregtarë dhe veçanërisht ato në Rumani (86 për qind).

Ministri Peci: Mbetem i përkushtuar për luftimin e korrupsionit

Prishtinë, 17 janar - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka përshëndetur organet e drejtësisë për arrestimin e dy të dyshuarve të hënën, të cilët pretendohet se morën para në emër të zyrtarëve të Ministrisë së Bujqësisë dhe u prematuan dy aplikuesve se do t'i shtyjnë para në listën e

përfituesve të granteve. Të dyshuarit janë kapur në flagrancë nga Policia e Kosovës.

Ministri Peci ka theksuar se veprimet e ndërmarra nga organet e rendit dhe të drejtësisë janë një shembull i mirë në luftimin e dukurive të tilla. “Mbetem i përkushtuar në luftën kundër

tentativave të tilla, krimin dhe korrupsionit. I falënderoj bujqit tanë për bashkëpunim dhe ndarje të informacioneve me ne dhe organet e rendit, si dhe i inkurajojmë ata që edhe në të ardhmen t'i denoncojnë parregullsitë dhe tentativat e tilla negative”, tha me këtë rast ministri Faton Peci.



E ardhmja e kriptomonedhave mund të jetë si ajo e dinarit irakian



Nga Lionel LAURENT
"Bloomberg"

Dinari irakian ishte shumë përpara kohës së tij. Shumë vite përpara se të shpikë Bitcoin, tregtarët amerikanë u joshën nga narrativa ekonomike e bërë virale, sipas së cilës monedha irakiane ishte një biletë për të shtënë në dorë pasuritë përrallore të Sadam Huseinit pas rrezimit të këtij të fundit nga pushteti.

Ekonomistët dhe entet rregullatore, i paralajmëruan se ky ishte një bast i rrezikshëm. Gjithsesi lojtarët në treg paguan tarifa të larta për të zotëruar një monedhë jolikuide, por për të cilën disa menduan se mund të bëhej më e vlefshme në botë. Në fakt ajo u zhvlerësua me 20 për qind vetëm gjatë vitit 2020. Dinari është sërish në mendjen e ekonomistëve, teksa tregu i kriptomonedhave po përjeton pasojat e kolapsit më të fundit, me 2 trilion dollarë vlerë të zhdukur nga një treg kaotik plot me mashtrime, vjedhje dhe kolapse të profilit të kompanive të profilit të lartë si FTX dhe BlockFi.

Paralelet nuk kanë të bëjnë vetëm me spekulimet tipike në këtë fushë, por me zhvillimin historik të dinarit si një mjet shkëmbimi. Ndërsa optimistët si investitori Bill Ekman besojnë se kriptomonedhat do të

rikthehen fuqishëm në rast se vjen rasti i duhur i përdorimit teknologjik, përvoja e Irakut sugjeron se mbijetesa e çdo lloj forme paraje, varet më shumë nga besimi tek institucionet që e mbështesin atë.

Në vitet 1990, pas Luftës së Parë të Gjirit, kishte në fakt 2 Irak-ë: Një në jug i kontrolluar nga Sadami, dhe një tjetër veri që ishte në thelb një protektorat kurd i mbështetur nga një zonë e ndalim-fluturimit. Për pasojë, dinari u degëzua në dy shtigje. Në jug, Sadami filloi shtypjen e parave për të mbështetur një ekonomi që po përballlej me sanksionet ndërkombëtare. Kartëmonedhat e reja që mbanin imazhin e tij, të quajtura "Sadam" ose dinarë, u prodhuan në vend me standarde shumë të dobëta. Inflacioni u rrit 250 për qind gjatë viteve 1991-1995, teksa u rrit oferta e parasë në qarkullim, vuri në dukje ish-kreu i Bankës së Anglisë, Mervin King në një fjalim të vitit 2004.

Në veri, ku dinari i ri nuk qarkullonte, dhe ku paratë e bankave nuk u shpronësuan nga regjimi i Sadamit, vazhdoi të përdorej dinari i vjetër "zvicëran" (quhej kështu sepse shtypej në lastra të prodhuara në Zvicër). Kjo gjë zgjati deri në rënien e Sadamit nga pushteti, pavarësisht se nuk kishte asnjë bankë qendrore apo

qeveri që i jepte vlerë.

Pasja e dy monedhave në të njëjtin vend ishte padyshim një zhvillim befasues. Fakti që "dinari zvicëran" vazhdoi të qarkullojë dhe madje u rrit në vlerë krahasuar me simotrën e tij, nuk është edhe aq i jashtëzakonshëm, duke pasur parasysh shkallën e keq-menaxhimit të monedhës që po ndodhte në jug.

Por "dinari zvicëran" nuk u rrit në vlerë vetëm kundrejt dinarit tjetër. Ai u rrit ndjeshëm edhe përkundrejt dollarit amerikan, duke u vlerësuar nga 18 dinarë për 1 dollar në vitin 2002, në 6 dinarë për dollar në kohën kur Bagdadi ra në duart e ushtrisë amerikane në vitin 2003.

Kjo gjë sugjeron se po vlerësoheshin 2 dukuritë e thella politike: Që pas luftës ndarja veri-jug do të bëhej më e qëndrueshme, dhe që vlera e "dinarit zvicëran" do të mbrohej nga institucione të reja të besueshme edhe pas ndryshimit të regjimit.

"Pra, vlera e dinarit zvicëran kishte të bënte gjithçka me politikën dhe aspak me politikën ekonomike të qeverisë që e lëshonte atë, sepse nuk ekzistonte një qeveri e tillë" - tha King. Rëndësia që kanë kriptomonedhat, bazohet tek besimi se vlera e tyre afatgjatë mund të varet nga ekzistenca e institucioneve të besueshme, diçka

që këtij sektori po i i mungon gjithnjë e më shumë.

Mundësitë teknologjike që përmenden shpesh, të ofruara nga monedhat virtuale – paratë e programueshme, kontratat inteligjente, transferimi i menjëhershëm i vlerës përmes monedhave të qëndrueshme – mund të jenë vetëm një "grusht pluhur" sa i përket adoptimit masiv jo-spekulativ, pa mbështetjen e emetuesve dhe platformave që kanë legjitimitet dhe të cilat ekzistojnë jashtë rrethit të mbyllur të kriptomonedhave.


Nga ana tjetër kjo mund të kërkojë një vull të jashtëmiratimi nga qeveritë dhe bankat qendrore, të cilat kriptomonedhat synojnë t'i nxjerrin jashtë lojë. Nëse kriptomonedha nuk do të bëjë më shumë sesa t'u shërbejë interesave të veçanta të entuziastëve të monedhave dixhitale, asaj mund t'i duhet të mbështetet në llojin e eksperimenteve që po kryhen aktualisht JPMorgan Chase & Co. apo edhe nga Bankat Qendrore për të emetuar euro osedollarë dixhitalë.

Ideja e fundit ka shkaktuar shumë kritika. Disa prej tyre janë të justifikuara, por ajo po josh shumëkënd pa nxitur skemat e pasurimit të shpejtë. Sigurisht, adhuresit e kriptomonedhavemund të japin

një shpjegim të ndryshëm për zhvillimin e "dinarit zvicëran". Monedha ishte relativisht superiore ë aspektin teknologjik, pasi ishte më e vështirë për t'u falsifikuar sesa simotra e saj me cilësi të dobët.

Dhe mbështetësit e sotëm të Bitcoin, mund të thonë se ajo që e bëri dinarin zvicëran të vlefshëm ishte zhvillimi i tij jashtë kontrollit shtetëror të Sadamit. Ndërkohë, teksa tregtarët dhe startup-et po përpiqen të sajojnë përgjigjet e tyre për deficitin e besimit ndaj kriptomonedhave, ka një nxitje për një vetë-rregullim dhe për t'i mbajtur larg autoritetet qeveritare. Por ka shumë pak gjasa që fjala e një kompanie apo auditori off-shore, ta bëjë kriptomonedhën të besueshme, sidomos pas falimentimit të një giganti në këtë sektori si FTX. Dështimi kolektiv për të pasur kujdesin e duhur edhe nga investitorët institucionalë të sofistikuar në këtë hapësirë, është ndoshta edhe më i turpshëm sesa mashtrimet me dinarët irakianë drejtuar konsumatorëve që nuk dyshojnë për asgjë.

Nëse ka një leksion që duhet nxjerrë nga Iraku, ai është se besueshmëria është më e rëndësishme se teknologjia. Dishepujt e kriptomonedhës vazhdojnë të dështojnë, pikërisht sepse nuk e përvetësojnë këtë mësim.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kosova U19 në futsall po përgatitet për ndeshjet parakualifikuese në Shkup



PRISHTINË, 17 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futsall U19 është duke u përgatitur për ndeshjet e rrethit paraleliminator për Kampionatin Evropian të cilat zhvillohen në Shkup më 20 dhe 21 janar. Kosova bën pjesë në grup me Gjermaninë dhe Maqedoninë e Veriut, derisa tutje kualifikohet skuadra që e fiton grupin. Stërvitjet e "dardanëve" U19 të futsallit po mbahen në palestrën "1 Tetori" në Prishtinë, derisa ekspedita e përfaqësueses udhëton të mërkurën në mesditë për në kryeqytetin e Maqedonisë së Veriut,

ku do t'i zhvillojë edhe dy stërvitje të tjera para përballjes së parë me Gjermaninë, të premtën në orën 17:00. Përzgjedhësi Suad Keçi është shprehur i kënaqur me kushtet e punës gjatë këtij grumbullimi si dhe me përkushtimin e lojtarëve për të dhënë më të mirën e tyre. Brengosëse për të mbetet fakti që shumicën e lojtarëve që ka në dispozicion janë pjesë e futbollit dhe gjatë këtyre ditëve është punuar shumë në aspektin taktik, por edhe në shpjegimin e rregullave të futsallit.

Mirëpo, ai ka bërë me dije se pothuajse me të njëjtin problem përballen edhe ekipet e tjera, duke pasur parasysh se ka mungesë të lojtarëve nën 19 vjeç që janë pjesë e klubeve të futsallit. Ndërkaq, dy lojtarët e vetëm që janë pjesë e futsallit edhe me klubet e tyre, Elton Demaj dhe Jon Krasniqi, kanë shprehur optimizëm për sukses në këtë rreth parakualifikues. Ata kanë thënë se edhe lojtarët e tjerë shumë shpejt janë ambientuar me lojën e futsallit dhe bashkëpunimi mes tyre është shumë i mirë.

SHKURT

Trepça '89 paraqet Gentrit Dumanin

Trepça '89 ka transferuar mbrojtësin e majtë Gentrit Dumani. Dumani bashkohet me klubin mitrovicas pas një aventure të shkurtër së fundmi te Prishtina ku qëndroi për gjashtë muaj. Hapësirat e pakta në formacion bën që mbrojtësi anësor të largohet nga kryeqyteti dhe karrierën ta vazhdojë në "Riza Lushta". "Gentrit Dumani i bashkohet familjes bardhegjelbër. Dumani luan pozitën e mbrojtësit të majtë dhe ka një karrierë të pasur në futbollin kosovar. Ai ka luajtur në ekipe të ndryshme si KF Flamurtari, KF Drenica, KF Malisheva dhe së fundmi ishte pjesë e FC Prishtinës", thuhet në njoftimin e 89-shit.

Marly Prince rikthehet te Vushtrria

Skuadra që bën gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll, Vushtrria, e ka rikthyer në radhët e saj e ka rikthyer portierin Marly Prince. Sezonin e kaluar portieri në fjalë ka qenë pjesë e Trepçës '89, derisa në të kaluarën ka luajtur për Vushtrrinë. "FC Vushtrria ka arritur marrëveshje me portierin Marly Prince. Prince sezonin e kaluar ka mbrojtur te KF Trepça 89. Marly edhe në të kaluarën ka mbrojtur ngjyrat e klubit tonë. Ai është edhe reprezentues i kombëtares së Kongos", thuhet në njoftim e skuadrës së Vushtrrisë.

Drita mori pjesë në seminarin 'TransferRoom'

FC Drita ka njoftuar se ishte pjesëmarrëse në samitin virtual të "TransferRoom" në mesin e 400 klubeve evropiane. Në këtë seminar mori pjesë menaxheri i klubit, Jetmir Salihu. Sipas njoftimit nga klubi gjilanas, kjo ishte mënyrë e mirë e shkëmbimit të përvojave për ta zgjeruar bashkëpunimin dhe për t'u lidhur me klube të ndryshme. FC Drita ishte i vetmi klub pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. "Nga klubi ynë mori pjesë menaxheri i klubit, Jetmir Salihu në Samitin e TransferRoom, e cila është mënyrë e mirë e shkëmbimit të përvojave për ta zgjeruar bashkëpunimin dhe për t'u lidhur me klube të ndryshme. Kjo platformë ndihmon për të promovuar e ofruar lojtarë në treg dhe sigurisht pjesëmarrje të tilla janë të mirëseardhura për klubin tonë", thuhet në njoftimin e skuadrës gjilanase.

Arijon Ibrahimoviçi vazhdon kontratën me Bayernin

MUNCHEN, 17 JANAR - Bayern Munchen ka konfirmuar se ka vazhduar kontratën me Arijon Ibrahimoviçin. Lojtari shqiptar me pasaportë gjermane ka firmosur marrëveshjen deri në vitin 2025. "FC Bayern ka zgjatur

kontaktin me sulmuesin Arijon Ibrahimoviç deri në vitin 2025. 17-vjeçari u transferua në kampusin e FC Bayern në vitin 2018 dhe u përfshi në kampin stërvitor të ekipit të parë javën e kaluar", thuhet në njoftimin e klubit

gjerman. Anëtar i bordit sportiv të Bayernit, Hasan Salihamidziq, është shprehur i lumtur që klubi vazhdoi kontratën me Arijon Ibrahimoviçin: "Ari Ibrahimoviç është zhvilluar

shumë mirë me ne dhe tani do të jetë pjesë e skuadrës sonë të parë. Stanisiq, Wanner, Schenk dhe tani Ari janë të gjithë talentë që ne i kemi ushqyer në kampusin e Bayernit dhe prej të cilëve presim shumë".



Krasniqi do të marrë pjesë në punëtorinë e NBA Junior League në Paris

PRISHTINË, 17 JANAR - Drejtori teknik i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Krasniqi, më 18-19 janar do të marrë pjesë në punëtorinë (Workshop) e NBA Junior League, që do të mbahet në Paris të Francës.

Në këtë punëtori do të marrin pjesë përfaqësues nga 50 shtete, ndërsa Krasniqi do ta përfaqësojë FBK-në dhe Kosovën në këtë ngjarje shumë të rëndësishme. Ndër temat kryesore është përmirësimi i programit të

Junior NBA Ligës në federatat përkatëse dhe zhvillimin e kësaj lige në vendet ku mbahet. Gjithashtu, do të ligjërohet për rritjen dhe masivizimin e basketbollit nëpërmjet JR NBA Ligës. Kosova nga viti i kaluar është

pjesë e kësaj lige ku kanë marrë pjesë 30 shkolla fillore, që ishin ndarë në dy konferenca, ndërsa më pas u zhvillua Final 4, për ta përcaktuar kampionin, kurse së shpejti do të fillojë edhe edicioni i ri në Kosovë.



Bostoni, ekipi lider në NBA

CHARLOTTE, 17 JANAR - Bostoni vijon të mbetet skuadra me rekordin më të mirë në NBA këtë sezon, duke korrur fitoren e 33-të. Skuadra e Celticsit fitoi me rezultat 130-118 në fushën e Charlottes, ndeshje ku shkëlqeu Jayson Tatum, autor i 51 pikëve. Fiton edhe Milwaukee, që falë 35 pikëve të Holiday, mundi me shifrat 132-119 Indianan. Rikthehet te fitorja skuadra e Lakersave, që mposhti me rezultat 140-132 Houstonin në një ndeshje spektakolare. LeBron James në formë të jashtëzakonshme, duke



realizuar 48 pikë për lakersat. Kampionët e Golden States mundën me shifrat 127-118 Washingtonin jashtë fushës, ndeshje ku vendimtarë ishin Curry me 41 pikë e Poole me 32 pikë. Toronto mundi me rezultat 123-121 New Yorkun pas kohës shtesë, me VanVleet që realizoi 33 pikë për

kanadezët. Në sekondën e fundit fiton ekipi i Utah Jazzit, që mundi 126-125 Minnesotan, ndeshje ku shtatë lojtarë të Jazzit realizuan mbi 10 pikë. Memphis i bashkohet Denverit në krye të renditjes në Perëndim, pas fitores me rezultat 136-106 ndaj Phoenixit (Ja Morant 29 pikë).

REZULTATET

Charlotte - Boston	118-130
Milwaukee - Indiana	132-119
Cleveland - New Orleans	113-103
New York - Toronto	121-123
Washington - Golden State	118-127
Atlanta - Miami	121-113
Minnesota - Utah Jazz	125-126
Memphis - Phoenix	136-106
Lakers - Houston	140-132

Murray triumfon pas 5 orësh, avancojnë edhe Rublev, Garcia e Sabalenka

MELBURN, 17 JANAR - Në Melburn janë zhvilluar ndeshjet e radhës të vlefshme për raundin e parë të grand slamit të Australian Open në tenis. Te meshkujt, ish-numri 1 në botë, britaniku Andy Murray, fitoi 3-2 ndaj italianit Matteo Berrettini (6-3, 6-3, 4-6, 6-7, 7-6), një ndeshje që zgjati gati 5 orë. Pa probleme avancojnë në raundin e dytë numri 5 në botë, rusi Andrey Rublev. Ai fitoi 3-0 (6-3, 6-4, 6-2) ndaj austriakut Dominic Thiem. Një biletë për në raundin e dytë siguroi edhe amerikanë Taylor Fritz, numri 8 në botë. Ai mundi 3-1 gjeorgjianin Basilashvili. Më tej shkon edhe norvegjezi Holger Rune (numri 9 në botë), që mundi 3-0 serbin Krajnoviq. Avancojnë më tej edhe spanjollli Pablo-Carreno Busta, francezi Jeremy Chardy, britaniku Daniel Evans e argjentinas Diego Schwartzman. Te femrat eliminohet ish-numri 1 në botë, tenistja spanjolle Garbine Muguruza. Ajo u mund 2-1 nga



belgia Elise Mertens (3-6, 7-6, 6-1). Në raundin e dytë avancojnë numri 4 në botë, tenistja franceze Caroline Garcia, që mundi 2-0 (6-3, 6-0) kanadezen Sedoq. Nuk zhgënjën bjellorusja Aryna Sabalenka, numri 5 në botë, që mundi 2-0 çeken

Martincova, ndërsa çekja tjetër Karolina Pliskova, mundi 2-0 kinezen Wang. Në raundin e tretë avancojnë edhe rusja Veronika Kudermetova, estonezja Anett Kontaveit e amerikania Sheldy Rogers.

SHKURT

Kloppi nuk e ka ndër mend të largohet nga Liverpooli

Liverpooli nuk po kalon nëpër një formë të mirë, por trajneri Jurgen Klopp nuk e ka ndër mend të largohet nga "Anfield". "Nëse askush nuk më thotë të shkoj, nuk do të largohem, kështu që kjo do të thotë se ndoshta ka një pikë ku duhet të ndryshojmë gjëra të tjera", ka thënë trajneri gjerman. Në anën tjetër, as zyrtarët e klubit anglez thuhet se nuk e kanë menduar shkarkimin e Kloppit. Madje te Liverpooli thuhet se po planifikojnë të tashmen dhe të ardhmen me 55-vjeçarin. Kloppi ka kontratë të vlefshme me Liverpoolin deri më 30 qershor 2026.

Inzaghi: Dëshirojmë ta mbrojmë këtë trofe

Derbi i "Madonnina"-s s'postohet në Riad, aty ku të mërkurën do të luhet finalja e Superkupës së Italisë. Inter - Milan premtojnë maksimumin. Ky është një trofe që dëshirojnë ta fitojnë. Për zikaltrit është një mundësi për t'u hakmarrë pas humbjes së pësuar në Serinë A. "Derbin e fundit e humbëm në mënyrë të pamërituar. Ky është vijimi i sezonit të shkuar. Dëshirojmë ta mbrojmë këtë trofe. Lukaku? Të shohim. Nuk jemi të sigurt nëse do të jetë në fushë kundër Milanit, nëse nuk ia del, shpresojmë të jetë kundër Empolit. Nuk kam vendosur ende mbi formacionin", ka thënë Simone Inzaghi, trajner i Interit.

Pioli, pas titullit në Serinë A, synon Superkupën

Superkupa e Italisë është një tjetër trofe pas titullit në Serinë A që e dëshiron trajneri i Milanit, Stefano Pioli. Sonte skuadra kuqezi luan në finale ndaj Interit. "Të fitosh është shumë e rëndësishme. E nisëm vitin e shkuar, ndërsa tani duhet t'i japim vazhdimësi, kjo do të thotë ta përforcojmë mentalitetin tonë si fitues. Java e fundit nuk ishte më e mira, por të mërkurën është një tjetër histori, është një derbi, është vetë historia. Nëse në mes i fut dhe një trofe i shton edhe më shumë vlerën kësaj ndeshjeje", ka thënë Pioli.

Drejtori i Leipzigut: Nkunku në verë do të jetë lojtar i Chelseat

Christopher Nkunku do të jetë lojtar i Chelseat në verë. Këtë lajm e ka konfirmuar drejtori sportiv i Leipzigut, Max Eberl. Duke folur për "Bild TV", Eberl theksoi se Nkunku do të bashkohet me "blutë" e Londrës. "Për fat të keq me Christopher Nkunku jam mjaft i qartë, do të bashkohet në verë me Chelsean", ka deklaruar drejtori sportiv i Leipzigut. Kështu skuadra e Potter do të përforcohet edhe më shumë, ku pas Mudryk që u zyrtarizua të dielën, në verë tjetër sulmuesi pritet të jetë pjesë e këtij ekipi.

Monchengladbachu refuzon ofertën e Bayernit për Sommerin

Borussia Monchengladbach e ka refuzuar ofertën e Bayern Munchen për Yann Sommer. Sipas "Sky Sport" të

Gjermanisë, Gladbach refuzoi një ofertë me vlerë prej 8 milionë eurosh, plus 1 milion të tjera në formë bonusi.

Bayerni është në kërkim të një portieri të ri, pasi Manuel Neuer humbi pjesën e mbetur të sezonit. Tani mbetet të

shihet nëse "bavarezët" do të dërgojnë një tjetër ofertë për portierin zviceran, apo do të heqin dorë nga ai. Përveç 34-

vjeçarit Sommer, në listën e Bayernit besohet se është Kevin Trapp i Eintracht Frankfurtit.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kleidie Mustafa shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" në Prishtinë, e lëshuar në vitin 2015 si dhe dëftesat e klasës së 10-të, 11-të dhe 12-të të po të njëjtës shkollë.

Egzon Daut Avdimetaj shpall të pavlefshme diplomën Kolegjit AAB-Prishtinë me nr. 2205/18.

- Taulant Leshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gëzim Haziri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Duahi" Gjakovë.

- Yll Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Duahi" Gjakovë.

- Sevdije Shala nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. " Haxhi Hoti" Rogovë KK Gjakovë.

- Florian Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III, të SH.M.T. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Aber Bibiqaj nga Novosella KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gëzim Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues